LIGJ
Nr.8336, datë 23.4.1998

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.8182, DATË 23.12.1996 "PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7609, DATË 22.9.1992 "PËR TARIFAT DOGANORE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozltat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

"Në ligjin nr.8182, datë 23.12.1996 "Për një ndryshim në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 "Për tarifat doganore""(i ndryshuar), në nenin 1, pika 1, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Për industrinë farmaceutike, taksat doganore të importit për lëndët e para të prodhimit farmaceutik, si dhe për ambalazhet farmaceutike të përdorura prej saj bëhen 5 për qind. Rastet e identifikimit të përdorimit të mallrave të sipërpërmendura për industrind farmaceutike duhet të vërtetohen nga Ministria e Shëndetësisë.".

Neni 2

Ky ligi hyn në fuqi më datë 5 maj 1998.

Shpallur me dekretin nr.2078, datë 8.5.1998 të presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani